

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË



MA MUHAMET PEÇI

## **Format e romanit të Ismail Kadaresë**

**“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kronikë në gur”, “Pallati i ëndrrave”, “E penguara / Requiem për Linda B.”**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori: Prof. dr. Kujtim Shala

Prishtinë, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Muhamet Peci

## **Format e romanit të Ismail Kadaresë**

**“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kronikë në gur”, “Pallati i ëndrrave”, “E penguara / Requiem për Linda B.”**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2021

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"

FACULTY OF PHILOLOGY

MA Muhamet Peci

## **The forms of Ismail Kadare's novel**

**"The General of the Dead Army", "Chronicle in Stone",  
"The Palace of Dreams", "A Girl in Exile: Requiem for  
Linda B."**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2021

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA MUHAMET PEÇI

## **Format e romanit të Ismail Kadaresë**

**“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kronikë në gur”, “Pallati i ëndrrave”, “E penguara / Requiem për Linda B.”**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori: Prof. dr. Kujtim Shala

Prishtinë, 2021

## Rezyme

Studimi i formës në letërsi është një nga mënyrat më të dendura që po merret në konsiderim për studimin e artit letrar nga studiuesit. Fillet e qasjes ndaj formës shihen që nga antika e tutje, por që nga decenia e dytë e shekullit të kaluar e në vazhdimësi deri në ditët e sotme, kjo qasje ka marrë hov të gjerë, duke u zhvilluar e zgjeruar në rrafsh të ndryshme teorike e metodologjike, të cilat për objekt kanë studimin e artit në përgjithësi dhe veprën letrare në veçanti.

Përderisa qasjet nistore formale, pavarësisht se nuk i përjashtuan zhanret e tjera, e vunë, kryesisht, poezinë në qendër të interesimit të tyre, me kalimin e kohës, studimi i veprës narrative filloi të pushtonte gjithnjë e më tepër terren, duke u konstituuar në një nga format më të begata sa i përket rezultateve në aspektin formal të studimit.

Studimi i formave në romanet e Kadaresë, që ka për objekt trajtimi, konkretisht, romanet “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kronikë në gur”, “Pallati i ëndrrave”, “E penguar / Requiem për Linda B.”, u është referuar pikërisht rezultateve të ndryshme që kanë dalë nga studimin i formës përmes metodash e teorish që si fokus kanë pasur veprën narrative letrare.

Metodologjia e punës lidhet me faktin se, secila prej këtyre veprave përfshin në vetvete një model të veçantë dhe të ndryshëm nga tjetra, prandaj edhe format e analizës i janë përshtatur kryesisht studimit të elementeve dominuese që përfaqësojnë secilin model, por, gjithashtu, është fokusuar edhe në studimin e disa elementeve që brenda për brenda modelit mund të mos jenë dominuese, por në raport me modelet e tjera aplikimi i tyre brenda veprës karakterizohet nga një mënyrë e pazakontë apo e veçantë qasjeje. Prandaj, kërkimi nuk përfshin qasje të njëjta ndaj teksteve në fjalë, analiza e formës përkufizohet në pajtim me kërkesat që ushtron modeli/teksti.

Për t'u realizuar ky studim janë përdorur kryesisht metodat që në thelb të koncepteve të tyre kanë formën si mënyrë të qasjes ndaj letërsisë si përgjithësi dhe artit narrativ në veçanti. Ndër to mund të përmenden: metoda formaliste, metoda strukturaliste, metoda e interpretimit, por gjithashtu edhe metoda të tjera: si komparative apo ajo e receptimit, etj.

Siç shihet, studimi është ndarë në gjashtë kapituj, të strukturuar në nënkapituj që parashetrojnë probleme të ndryshme që dalin nga analiza e formës. Secila nga veprat është trajtuar në nga një kapitull të veçantë, më pas, në dy kapitujt e fundit të tëra veprat janë shqyrtuar në mënyrë të përmbledhur, duke u vënë në dukje elemente të ndryshme që i karakterizojnë secilën prej tyre në veçanti dhe të gjitha bashkë si tërësi.

Kërkimi mbi format në këto katër vepra përfshin studimin e formës si strukturë, qoftë duke u parë se si bashkërendohen elemente të ndryshme, në veçanti, brenda secilës vepër, qoftë se si organizohen e lidhen për të strukturuar tërësinë e saj. Gjithashtu, nuk është lënë pas dore as studimi i formës si stil, për të evidentuar mënyrën apo teknikat e ushtruara, me anë të të cilave i është dhënë formë secilit tekst/model.

Duke pasur para sysh këtë, brenda veprave janë hetuar elemente të llojllojshme që shpesh janë parë prej pikëpamjesh të ndryshme. P.sh. personazhet shqyrtohen, nga një anë, për nga mënyra se si ndërtohen në vetvete dhe se si funksionalizohen në raport me të ndodhurat, nga ana tjetër paraqitet roli i tyre sa i përket strukturimit të përgjithshëm të veprës, kujto këtu “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”, ku organizimi specifik i personazheve i jep atij statusin e romanit të personazhit, apo personazhin që rrëfen te “Kronikë në gur”, apo personazhin figurë dhe sintezë të “Pallati i ëndrrave”.

Po ashtu, edhe hapësira dhe koha shihen përmes pikëvështrimeve të shumëfishta, duke u parë në një aspekt koha dhe hapësira formale/objektive, pra si kohë dhe vend që përcaktojnë se kur dhe ku zhvillohen ngjarjet, duke u trajtuar në vazhdim mënyra se si ndërthuren këto elemente në organizimin e diskursit narrativ, qoftë në vetvete, qoftë me njëra-tjetrën, gjithashtu, përmes analizimit të formave të shprehjes, të dyja do të trajtohen përtej kontekstit formal e strukturues, si shprehje figurative që përfaqësojnë forma të ndryshme të mënyrës se si ndërtohen kuptime të reja përmes tyre.

Në fakt, organizimi në mënyrë specifike i gjuhës, ka drejtuar fokusin e studimit në natyrën e shumëfishtë kuptimore, duke marrë si shembull jo vetëm sekuenca e njësi të ndryshme tekstore brenda veprave, apo duke parë nën prizmin e analizës gjuhësore elemente të caktuara në ndërtimin e veprave, por ndonjëherë, si në rastin e romanit “Pallati i ëndrrave” duke e parë tekstin për nga ky aspekt në tërësi dhe si tërësi, duke imponuar një kërkim më të theksuar të mjeteve e teknikave që përdoren për t’u arritur ky rezultat. Në ndërkohë, studimi i gjuhës në aspektin struktural, ka përfshirë analizimin e saj në rrafshin semiotik, ku është vënë në plan të parë trajtimi i shenjës gjuhësore brenda sistemeve, me theks të veçantë në sistemin konotativ, me shënjestër evidentimin dhe mënyrat se si ndërtohen kodet në tekst.

Në këtë studim është shtjelluar edhe shqyrtimi i mënyrave të rrëfimit, ku është përfshirë trajtimi i formave të diskurseve që dalin nga rrëfimi i ndodhive dhe fjalëve. Duke u synuar përcaktimi i formës dominuese të diskursit, më tutje, për t’u arsyetuar dhe hulumtuar roli dhe funksioni i saj.

Sa i përket rrëfimit, përveç të tjerash, një ndër elementet më të shqyrtuara, gati sistematikisht në secilën vepër është aspekti narratorial. Janë evidentuar dhe përcaktuar llojet e ndryshme të narratorëve; janë përkufizuar suazat në të cilat bëhet rrëfimi, duke u përfshirë edhe instancat e rrëfimit; është trajtuar qasja, roli dhe funksioni i tyre në strukturën e përgjithshme të veprave; janë parë veçoritë që i karakterizojnë; është shpalosur përzgjedhja e teknikave të rrëfimit; janë trajtuar mënyrat e veçanta të përfshirjes së tyre në një tërësi apo tjetër vepër, apo në pjesë të veçanta të tyre; është shtjelluar statusi i rrëfimitarit; kërkimi është ndalur edhe në relacionet që janë krijuar mes rrëfimitarit dhe fokalizatorit, apo rrëfimitarit dhe narraterit, ku më tutje është bërë edhe analizimi i hollësishëm e këtyre elementeve, pra aspektit të fokalizimit në tekst dhe përkufizimit, statusit dhe rolit të narraterit/narraterëve.

Sa i përket formave të përmbajtjes, në këtë studim, zënë vend edhe mënyrat se si kompozicionohen së brendshmi temat në vetvete brenda veprave, por temat shihen edhe në aspektin e formave të mënyrës, pra paraqiten teknikat me anë të të cilave këto tema pozicionohen, alternohen e konfigurohen në strukturimin e përgjithshëm të veprave.

Paratekstualitetit dhe ndërtektstualiteti janë shtjelluar në kapitujt përmbyllës të punimit.

Sa i përket paratekstualitetit studimi është përqendruar në elementet peritekstuale me fokus të veçantë në rrafshin e titologjisë. Janë parë dhe analizuar llojet dhe funksionet e këtyre

elementeve peritekstuale, janë nxjerrë konkluzionet e nevojshme rreth marrëdhënieve që krijohen mes këtyre elementeve dhe atyre që u qasen (receptuesit), por edhe mes tyre dhe vet intratekstut të cilit i përkasin. Gjithashtu, është përfshirë edhe një qasje analitike që merret me zbërthimin e periteksteve në fjalë, për të vënë në dukje, atje ku është përfshirë, funksionin e tyre paraprirës dhe përmbledhës apo edhe befasues në raport me intratekstet që përfaqësojnë.

Kapitulli përmbyllës “Ndërtekstualiteti”, pas një shqyrtimi hapës dhe të shkurtër rreth intertekstualitetit, lindjes së termit, asaj që përfaqëson, qasjeve ndaj tij, ndalet konkretisht në veprat e Kadaresë që janë objekt studimi, për t’i parë ato pikërisht përmes prizmit ndërtekstual.

Kjo formë e analizës nënkupton mbështetjen në konceptin teorik të intertekstualitetit, e cila është aplikuar praktikisht në tekstet në fjalë, dhe ka rezultuar në një hulumtim, por edhe interpretim të përmbledhur të elementeve ndërtekstuale që dalin nga veprat.

Komunikimin me tekstet e tjera Kadare e përfshin sistematikisht në veprat e tij. Ky (ndër)komunikim me tekstet e tjera shtrihet në fusha të ndryshme si: atë letrare, atë religjioze, atë mitologjike, përfshin tekste nga historia, filozofia, kultura, sociologjia, psikologjia, linguistika, politika, etj. Veprat e tij ndërtojnë marrëdhënie ndërtekstuale me etnologjinë, etnografinë, antropologjinë, folklorin e traditën, me lloje kultesh e ritesh të ndryshme, etj.

Intertekstualiteti shihet si harmoni mes shprehjes dhe parashtrimit, shpalljes, që prodhon një tekst me gjuhë të pakufizuar vetëm në një kuptim, prandaj, prania e elementeve ndërtekstuale në veprën e Kadaresë jep pikërisht këtë rezultat. Ai e lakon gjuhën e veprave të tij, veç të tjerash, edhe përmes përdorimeve intertekstuale, të cilat i hapin udhë kuptimeve të shumëfishta që evokohen përmes (ndër)komunikimit në nivele të ndryshme që tekstet e tij ndërtojnë me tekste e burime tjera.

Teza e doktoraturës “Format e romanit të Ismail Kadaresë / “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Kronikë në gur”, “Pallati i ëndrrave”, “E penguara - Requiem për Linda B.””, është një punim gjithëpërfshirës me në qendër njohjen dhe studimin e formës së kësaj krijimtari. Një hulumtim i cili ka zbuluar përmes analizimit të modeleve të zgjedhura, mënyrat, teknikat, stilet, se si organizohet, ndërtohet e strukturohet teksti narrativ, manifestuar konkretisht në veprat e lartpërmendura.



## Summary

The study of form in literature is one of the densest ways being considered for the study of literary art by scholars. The beginnings of the approach to form can be seen from antiquity onwards, but since the second decade of the last century and continuously until today, this approach has gained momentum, developing and expanding in various theoretical and methodological levels, which have as their object the study of art in general and literary work in particular.

While the initial formal approaches, although they did not exclude other genres, put poetry mainly at the center of their interest, over time, the study of the narrative work began to occupy more and more ground, and became one of the most prosperous forms regarding to the aspect of formal study.

The study of forms in Kadare's novels, which has as object of treatment, namely, the novels "The General of the Dead Army", "Chronicle in stone", "The Palace of Dreams", "A Girl in Exile: Requiem for Linda B.", is referring precisely to the various results that have emerged from the study of form through methods and theories that their main focus was the literary narrative work.

The methodology of the work is related to the fact that each of these novels includes in itself a special and different model from the other, therefore the forms of analysis are mainly adapted to the study of the dominant elements that approach each model, but is also focused in the study of some elements that within the model may not be dominant, but in relation to the other models, their application within the work is characterized by an unusual or special way of approach. Therefore, the search does not include the same approaches to the texts in question; the analysis of form is defined according to the requirements of each model / text.

In order to carry out this study, the methods that have been used have mainly in the essence of their concepts the study of form as a way of approaching to literature in general and narrative art in particular. Among them can be mentioned: formalist method, structuralist method, method of interpretation, but also other methods: as comparative or that of reception, etc.

As can be seen, the study is divided into six chapters, structured into subchapters that present various problems arising from the analysis of form. Each of the novels is treated in a separate chapter, then, in the last two chapters all the works are reviewed in a concise manner, noting the different elements that characterize each of them in particular and all together as a whole.

The study of forms in these four novels involves the study of form as a structure; either by looking at how different elements are coordinated in particular within each work, or by how these elements are organized and linked to structure its entirety. Also, the study of form as a style has not been neglected, in order to identify the way or techniques practiced, through which each text / model has been given shape.

With this in mind, within the works various elements have been investigated that are often seen from different points of view. For example, the characters are examined, on the one hand, it is seen the way they are constructed in themselves and the way they are functionalized in relation to the events, on the other hand, their role is presented in terms of the overall structure of the work, remember here "The General of the Dead Army", where the specific organization of the characters gives to the novel the status of the *novel of character*, or the character that narrates in "Chronicle in stone", or the synthetic / figure character of the "Palace of Dreams".

Also, space and time are seen through multiple points of view too, formal / objective time and space, i.e. as time and place that determine when and where events take place is one of the aspects of analysis that this study represents, by being seen the ways in which these elements intertwine in the organization of narrative discourse, either in themselves (time with time or space with space) or with each other (time with space), also, through the analysis of forms of expression, both will be treated beyond the formal and structural context, as figurative expressions that approach different forms which show the ways that new meanings are constructed through them (time and space).

In fact, the specific organization of language has directed the focus of the study to its multiple meaningful nature, taking as an example not only different textual sequences or units within the works and looking under the prism of linguistic analysis certain elements in the construction of works, but sometimes, as in the case of the novel "Palace of Dreams" looking at the text from this aspect in its entirety and as a whole, imposing a more noted search of the tools and techniques used to achieve this result. In the meantime, the study of language in the structural aspect has included its analysis in the semiotic plane, where the treatment of the linguistic sign within the systems is put in the foreground, with special emphasis on the connotative system, with the aim of identifying the ways in which codes are constructed within the text.

In this study is also elaborated the examination of the ways of narration, which includes the treatment of the forms of discourses that arise from the narration of events and words. Aiming to determine the dominant form of discourse, but also to justify and research its role and function.

As for the narrating, among others, it is one of the most examined elements almost systematically in each work. Different types of narrators have been identified and defined; the frameworks in which the narration takes place are defined, including the instances of narrating; their approach, role and function in the overall structure of works is addressed; the features that characterize them have been seen; the selection of storytelling techniques is revealed; special ways of their involvement in one or the other work, or in separate parts of them are treated; the status of the narrator is elaborated; the research also is focused on the relations that have been established between the narrator and the focalizer, or between the narrator and the narratee, different aspect of focalization in the text have been analyzed also, and it is seen in a more definitively way the status and role of the narratee / narratees in the texts.

Regarding the forms of content, it is studied the way in which the themes are composed internally within the works, but the themes are also seen in terms of the forms of the manner, i.e. the techniques by which these themes are positioned, alternated and configured in the overall structuring of works.

In the concluding chapters of the paper are elaborated paratextuality and intertextuality.

This study is focused on peritextual elements with a special focus on the field of titology. Have been seen and analyzed the types and functions of these peritextual elements, and the necessary

conclusions have been drawn about the relationships that are created between these elements and the addressee, but also between them and the intratext itself to which they belong. Also is included an analytical approach that deals with the decoding of the peritexts in question, to point out, where included, their anticipatory and summary or even surprising function in relation to the intratexts they represent.

The concluding chapter "Intertextuality", after an open and brief review about intertextuality, the birth of the term, what it represents, approaches to it, focuses specifically on Kadare's works that are the object of study, to see them precisely through the intertextual prism.

This form of analysis implies reliance on the theoretical concept of intertextuality, which has been practically applied in the texts in question and has resulted in a research, but also a concise interpretation of the intertextual elements that emerge from the works.

Kadare systematically includes communication with other texts in his works. This (trans)communication with other texts extends to different fields such as: literary, religious, mythological, includes texts from history, philosophy, culture, sociology, psychology, linguistics, politics, etc. His works build intertextual relations with ethnology, ethnography, anthropology, folklore and tradition, with different types of cults and rites, etc.

Intertextuality is seen as the harmony between the expression and the submission; it is the proclamation, which produces a text with unlimited language in only one sense, therefore, the presence of intertextual elements in Kadare's novels gives exactly this result. He bends the language of his works, among other things, through intertextual uses, which pave the way for multiple meanings that are evoked through (trans)communication at different levels that his texts create with other texts and sources.

The doctoral thesis "The forms of Ismail Kadare's novel / "The General of the Dead Army", "Chronicle in stone", "The Palace of Dreams", "A Girl in Exile: Requiem for Linda B." is a comprehensive work focusing on recognition and the study of form in this creativity. A research which has revealed through the analysis of selected models: ways, techniques, styles, how the narrative text is organized, constructed and structured, manifested concretely in the above mentioned work.

